

# ANALIZA E VENDIMEVE TË GJYKATËS THEMELORE SHKUPI II-SHKUP

lidhur me zbatimin e Ligjit për përgjegjësi  
civile për shpifje dhe fyerje të kryera  
nëpërmjet mediave të sjellura  
në vitin 2017 dhe 2018



ANA PANOSKA

.....

Analiza e vendimeve  
të gjykatës themelore Shkupi II-Shkup  
lidhur me zbatimin e  
Ligjit për përgjegjësi civile për  
shpifje dhe fyerje të kryera  
nëpërmjet mediave të sjellura  
në vitin 2017 dhe 2018



SHOQATA E GAZETARËVE TË MAQEDONISË



**L**igji për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje është në fuqi më shumë se 6 vite. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) në bashkëpunim me avokatët dhe gazetarë ka përgatitur tre analiza për zbatimin e Ligjit për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje në lëndët e formuara kundër gazetarëve dhe medimeve, të cilat janë publikuar në ueb faqen e SHGM-së.

Në analizat e përgatitura në qershor të vitit 2015 persona të autorizuar të SHGM-së në periudhë prej shtatë muajsh kanë ndjekur gjithsej 39 procese gjyqësore në 106 seanca dëgjimore. Në këtë periudhë janë sjellur tetë aktgjykime, nga të cilat në shtatë është refuzuar kërkes-padia dhe nuk është vërtetuar përgjegjësia qytetare për shpifje dhe fyerje. Vetëm në një rast gjykata pjesërisht e ka pranuar kërkes-padinë, ka vërtetuar përgjegjësi qytetare për shpifje dhe fyerje, por nuk ka sjellur vendim për kompensimin e dëmit.

Përfundimet kryesore të përmbledhura nga kjo analizë janë:

- Gjykatësit që veprojnë në këto lëndë në mënyrë të rregulltë e zbatojnë ligjin dhe i respektojnë të drejtat e dy palëve në procedurë, por ekzistojnë lëshime procedurale në faza të caktuara të procedurës që nuk ndikohen për marrje të vendimeve të ligjshme dhe korrekte.
- Kohëzgjatja e procedurës dhe periudhat ndërmjet seancave të caktuara vërtetojnë joefikasitet të skajshëm të gjykatave.

Në botimin „Zbatimi i Ligjit për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje në periudhën prej fillimit të vitit 2013 deri në vitin 2016” (Shkup, 2016) është konkluduar se procedurat në të cilat si palë kanë marrë pjesë udhëheqës të pozitive shtetërore janë zhvilluar më shpejtë, ndërsa gjatë veprimit të gjykatësve është vërejtur tendencë e mbrojtjes së pabazuar të nderit dhe reputacionit të zyrtarëve. Gjithashtu, konstatohet që gjykatësit nuk janë trajnuar mjaftueshëm për udhëheqjen e procedurave të tilla dhe që nuk e shfrytëzojnë praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut.

Në botimin e SHGM-së „Zbatimi i Ligjit për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje në proceset gjyqësore kundër gazetarëve” (Shkup, 2017) janë analizuar gjithsej shtatë aktgjykime të plotëfuqishme për shpifje dhe fyerje në të cilat janë paditur gazetarët. Të gjitha kërkes-paditë janë refuzuar si të pabaza.

Tre analizat janë pjesë e aktiviteteve të vazhdueshme të SHGM-së për monitorimin e zbatimit të Ligjit për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje dhe ndikimi i saj ndaj gazetarisë në Maqedoni.

## OBJEKT I ANALIZËS

Kjo analizë e katërt është realizuar në bazë të të dhënave nga 14 vendime të shkallës së parë, që janë marrë nga ueb faqja e Gjykatës Themelore Shkupi II-SHKUP. Vendimet janë sjellur nga periudha e muajit tetor 2016 deri në janar të vitit 2018 dhe janë anonimizuar, gjegjësisht aty janë shënuar të dhënat personale të paditësve dhe të paditurve, konform obligimit për mbrojtje të të dhënave personale.

Vendimet janë marrë pas zbatimit të procedurave të formuara sipas padive për përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje. Është vërtetuar se nga gjithsej 14 vendime të shkallës së parë gjykata ka sjellur:

- 6 aktgjykime me të cilat kërkes-padia është pranuar ose pjesërisht e pranuar
- 4 aktgjykime me të cilat kërkes-padia është refuzuar si e pabazë
- 4 vendime me të cilat padia është konsideruar si e tërhequr

## KARAKTERISTIKAT E VENDIMEVE

- -Nga paraqitja e padisë deri në sjelljen e vendimit të shkallës së parë procedurat mesatarisht kanë zgjatur dy vite e gjysmë.
- -Në të gjitha procedurat si paditësin ashtu edhe të paditurin e kanë përfaqësuar avokatët;
- - Në të gjitha procedurat sipas padisë së paditësit ekzistojnë përgjigje me shkrim të padisë nga ana e autorizuarve të të paditurve;
- -Në asnjërën nga procedurat që kanë përfunduar me aktgjykim të shkallës së parë nuk është caktuar shuma e kërkuar për kompensim të dëmit, gjegjësisht në çdo rast kur është caktuar dëmi i vërtetuar në shumë parash, atëherë është caktuar shuma më e vogël nga ajo që është kërkuar në kërkesë-padinë.
- - Në tre aktgjykime nuk është caktuar shuma e kërkuar e dëmit jomaterial në të holla, por i padituri është detyruar me shpenzimet e veta ta publikoj aktgjykimin nën kushte që ia ka përcaktuar gjygi;
- -Në disa procedura të autorizuarit që i kanë përfaqësuar palët që kanë pasur sukses në procedurë, nuk iu është caktuar shpërblimi i kërkuar për shërbimet e avokatit por është caktuar shuma më e ulët;

**Kryerësit e shpifjes dhe fyerjes, në të shumtën e rasteve janë personat juridik nëpërmjet të cilave media dhe portale është shkaktuar shpifja apo fyerja. Nga personat fizik për të cilët është vërtetuar që janë përgjegjës, numri më i lartë janë redaktorë dhe pronarë të mediave.**







## AKTGJYKIM P5-34/16

- Padiësi: A.A. nga s.Z.
- Të paditurit: DTIK ATV-M.K.DOOEL S. si persona juridik dhe I.S. nga S. si person fizik.
- Baza: Kompensim i dëmit për shpifje
- Vlera: 25.000 euro

Paditësi A.A. është kryetar i partisë politike të Bashkimit Demokratik për Integrim- BDI. Me aktgjykim është vërtetuar se i padituri i parë- person juridik DTIK ATV-M.K DOOEL SHKUP në uebfaqen e internetit të gazetës ditore Lajm, në të cilën janë publikuar fakte të pavërteta për nderin dhe reputacionin e paditësit, në formë të kërcënimit që do ta dëbon nga partia kryetar i së cilës është vetpaditësi, nuk ka legjitimitet pasiv, kështu që nuk mundet të përgjigjet për faktet e pavërteta nga ana e të paditurit të dytë.

Për shkak të kësaj, gjykata e shkallës së parë pas procedurës së zbatuar ka sjellur aktgjykim me të cilin:

Kërkesë-padinë që personi juridik ti paguan paditësit në emër të kompensimit jomaterial për cenimit të nderit dhe reputacionit vlerën prej 15.000 eurove, gjykata e ka refuzuar si të pabazë. Gjukata e ka detyruar paditësin A.A. ti kompensojë të paditurit të parë shpenzimet e procedurës në lartësin prej 76.044,00 denarë, ndërsa kërkesën për dallim të shpenzimeve të paralajmëruara prej 97.562,00 denarë, gjykata e ka refuzuar si të pabazë.



## 2

## AKTGJYKIM P5-73/16

- Padiësi: D.P.L. nga S.
- Të paditurit: S.I. nga K. si person fizik dhe kompania për prodhim, tregti dhe marketing P.M. DOOEL import-eksport S. si person juridik
- Baza: Kompensimi i dëmit për shpifje në pesë raste
- Vlera: 615.000,00 denarë

Me aktgjykim është vërtetuar që i padituri i parë S.I. nga K, si kryeredaktor dhe përgjegjës i të paditurit të dytë Kompani për prodhim, tregti dhe marketing P.M DOOEL import-eksport S., nuk është përgjegjës për shpifjen e kryer ndaj padiësit nëpërmjet publikimit të disa herë me rradhë fakteve të pavërteta në faqen e internetit maktel.mk me qëllim që të cenohet nderin dhe reputacionin e padiësit, pasi që tekstet, përmbajtja dhe komentet janë publikuar në faqe private të internetit që nuk paraqet medium, po as edhe mjet informimi, andaj i padituri nuk mund të përgjigjet për faktet e publikuara të paditurit të dytë sepse nuk ka legjitimim pasiv.

Për shkak të kësaj gjykata e shkallës së parë pas zbatimit të procedurës ka sjellur Aktgjykim me të cilën e ka refuzuar kërkes-padinë që të vërtetohet se personi fizik S.I. është përgjegjës për shpifjen e kryer ndaj padiësit nëpërmjet publikimit të disa herë me rradhë fakteve të pavërteta në faqen e internetit maktel.mk me qëllim që të cenohet nderin dhe reputacionin e padiësit, si





## AKTGJYKIM P5-1/17

- Paditësi: E.K. nga S.
- Të paditurit: D.N. nga S. si person fizik dhe Kompaninë për botim, veprimtari grafike dhe tregti N.P.K DOOEL S. si person juridik
- Baza: Kompensim i dëmit për shpifje
- Vlera: 25.000 euro

Gjykata e shkallës së parë pas zbatimit të procedurës ka sjellur Aktgjykim me të cilën kërkes-padia është pranuar pjesërisht.

Me aktgjykimin është vërtetuar përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje të të paditurit të parë D.N. dhe të paditurit të dytë Kompani për botim, veprimtari grafike dhe tregti N.P.K DOOEL S. ndaj paditësit pasi që i pari në cilësinë e kryeredaktorit, ndërsa i dyti në cilësinë e botuesit të portalit kanë publikuar tekst me titull „Biznes interesat e dyshimta po dëmtojnë marrëdhëniet e mira fqinjësore të Kosovës” në të cilën janë publikuar faktet e pavërteta të dëmshme për nderin dhe reputacionin e paditësit.

Me aktgjykim është vërtetuar përgjegjësi civile për shpifje dhe fyerje të kërkes-padisë që të ngarkohet i padituri i parë D.N. në emër të kompensimit të dëmit jomaterial për cenim të të drejtave personale të nderit dhe reputacionit ti paguan kompensim të dëmit në vlerë prej 10.000 eurove në kundërvlerë de-



## 4

**AKTGJYKIM P5-69/15**

- Padi tës: Fondacioni për internet dhe shoqëri M.S.
- I paditur: S.M. nga G.
- Baza: Kompensim i dëmit për fyerje dhe shpifje
- Vlera 120.000,00 denarë

Gjykata e shkallës së parë pas zbatimit të procedurës me kërkes-padi të paditësit për vërtetim të përgjegjësisë për kryerjen e fyerjes dhe shpifjes nga i padituri S.M., i cili nëpërmjet internet portalit Almakos ka publikuar tekst me titull „Paradoks: Vetëm në M. me financa ndërkombëtare e mbrojnë regjimin pa para” dhe me qëllim që ta diskreditoj paditësin ka shprehur mendim poshtërues me ç’rast e ka cenuar të drejtën e tij për reputacion, ka sjellur Aktgjykim ndaj kërkes-padisë së paditësit Fondacioni për internet dhe shoqëri e regjistruar në RM ku ka vërtetuar përgjegjësi të të paditurit, personit fizik S.M. nga G. për kryerjen e fyerjes, si dhe përgjegjësi për kryerjen e shpifjes me ç’rast pjesërisht e ka pranuar kërkes-padinë dhe e ka ngarkuar të paditurin me shpenzimet e veta ta publikon përmbajtjen e Aktgjykimit në hapësirë jo më të vogël se 1/8 e faqes, edhe atë nga faqja e parë deri në faqen e pestë të medias së shkruar.







## VENDIM P5-14/17 dhe PR-15/17

### Padi me kërkesë për caktimin e masës së përkohëshme

- Padi tës: Shoqëri aksionere për prodhimin e energjisë elektrike T.N. në pronësi shtetërore N.
- I paditur: M.S. nga S. me vendbanim të panjohur
- Baza: Kompensim i dëmit për fyerje
- Vlera: 300.000,00 denarë

Pas zbatimit të procedurës për vërtetimin e përgjegjësisë civile për fyerje me kërkesë që ti paguan në emër të cenimit të të drejtave personale të reputacionit në vlerë prej 300.000,00 denarëve, gjykata me Vendim ka vërtetuar se padia e paraqitur nga padi tësi person juridik kundër të paditurit person fizik me vendbanim të panjohur për shkak të së cilës iu është caktuar përfaqësues të përkohshëm-avokat, konsiderohet si e tërhequr.

Padi tësi obligohet që përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit t'ia kompenzon shpenzimet e procedurës prej 7.800,00 denarëve

Vendimi me të cilin është vërtetuar se padia konsiderohet e tërhequr është sjellur për shkak që padi tësi i thirrur me rregull dhe përfaqësuesi i tij nuk janë paraqitur në seancën e caktuar dëgjimore dhe nuk e kanë arsyetuar mungesën e tyre.





## VENDIM P5-8/17

- Padiës: D.D. nga K.
- I Paditur: Shoqëri për hulumtim, analiza dhe marketing C.DOOEL S.
- Baza: Kompensim i dëmit për shpifje
- Vlera: 60.000,00 denarë

Pas zbatimit të procedurës për vërtetimin e përgjegjësisë civile për shpifje me kërkesë për kompensim të dëmit jomaterial prej 60.000,00 denarëve, gjygi me Vendim ka vërtetuar që padia e parashtruar nga padiësi person fizik nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar kundër të paditurit person juridik Shoqëri për hulumtim, analiza dhe marketing C.DOOEL S., konsiderohet si e tërhequr përshkak që padiësi në afat ligjor prej 15 ditësh nga paraqitja e padisë nuk e paguar tarifën e padisë.

Padiësi është ngarkuar që të paguan tarifën gjyqësore për sjelljen e vendimit në lartësi të vlerës prej 8.000,00 denarësh.





## AKTGJYKIM P5-18/16

- Padiës: A.K., G.N. dhe T.M nga S.
- I paditur: J.K. nga S.M nëpërmjet të autorizuarit
- Baza: Kompensim i dëmit për shpifje
- Vlera: 440.000,00 denarë

Pas zbatimit të procedurës pas paraqitjes së padisë të padiësve persona fizik A.K., G.N. dhe T.M. nga S. kundër të paditurit person fizik J.K. nga S. nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me kërkesë për vërtetimin e përgjegjësisë për shpifje e kryer nga i padituri si kryeredaktor i mediumit të shkruar- gazetës javore „Fokus” dhe kërkesës për vërtetimin e kompensimit të dëmit për cenim të nderit dhe reputacionit në vlerë prej 120.000,00 denarësh të parit dhe të dytit si dhe 200.000,00 denarë paditësit T.M., gjykata e ka refuzuar kërkes-padinë si të pabazë.

Paditësit janë ngarkuar që në mënyrë solidare të paditurit t’ia paguajnë shpenzimet e procedurës në vlerë prej 78.756,00 denarëve.

Kërkes-padia është refuzuar si e pabazë përshkak që gjykata, në bazë të vlerësimit nga dëshmitë e paraqitura ka vërtetuar që i padituri nuk ka legjitimim pasiv, gjegjësisht që kryeredaktori, në këtë rast nuk përgjigjet sipas Ligjit për mediumet sepse në atë moment ka pasur rolin e personit tjetër në mediumin konkret dhe jo kryeredaktor ashtu siç është paraqitur në kërkes-padinë.



imin e të drejtave personale me fyerjen e theksuar, edhe atë i padituri L.Z. ti paguan shumë prej 22.755,00 denarë, paditësi D.P.L. ti paguan shumë prej 113.775,00 denarë dhe personi juridik i paditur ti paguan shumë prej 170.970,00 denarë.

Kërkes-padia e paditësve të caktohet përgjegjësi për kryerjen e shpifjes për publikimin e fakteve të pavërteta në artikullin gazetaresk dhe paditësit Shoqëri qytetare C.C. , të paditurit L.Z. ti paguajnë kompensim në të holla për cenimin e të drejtave personale në vlerë prej 45.510,00 denarë, i padituri D.P.L. ti paguan 227.550,00 denarë dhe personi juridik i paditur ti paguan 341.940,00, gjykata e refuzoi si të pabazë.

Gjykata ka vendosur që çdo palë ti paguan shpenzimet e procedurës.

Refuzimi i kërkes-padisë për fyerje mbështetet në atë që gjykata ka vërtetuar se nuk ka shpifje konform nenit 8 dhe 10 të LPCFSH dhe nenit 10 të LKEDN.

Kërkes-padia e pranuar për fyerje sipas gjykatës mbështetet në dëshmitë e procedurës dhe ekziston përgjegjësi konform LPCFSH, si dhe përshkak faktit që i padituri L.Z. gjatë dhënies së deklaratës i ka kërkuar falje paditësit. Sipas gjykatës, kjo ka qenë arsyeja që të vërtetohet përgjegjësia, por mos të pranohet kërkesa për kompensim të dëmit në të holla për shkelje të të drejtave personale.

Refuzimi i kërkes-padisë për shpifje mbështetet në atë që i padituri L.Z. si gazetar ka provuar se faktet që i ka thënë janë të pavërteta.







## AKTGJYKIM P5-61/16

- - Paditës Q.Q. nga G.
- - I paditur I.P. nga S.
- - Baza: Kompensim i dëmit për shpifje
- - Vlera: 300.000,00 denarë

Pas zbatimit të procedurës për caktimin e përgjegjesisë së të paditurit për shpifje dhe kërkesës së paditësit në emër të kompensimit të dëmit jomaterial për cenim të reputacionit që i padituri ti paguan vlerën prej 150.000,00 denarë, gjykata e shpalli pjesërisht të pranueshme.

Është vërtetuar përgjegjësi e të paditurit për kryerjen e shpifjes në emision televiziv Analiza 24 të programit televiziv 24 Vesti. Kërkesë-padia për vërtetim të përgjegjesisë për fyerje dhe kërkesa e paditësit për cenim të nderit dhe reputacionit të tij në vlerë prej 150.000,00 denarësh janë refuzuar si të pabaza.

Si e pabazë është refuzuar kërkes-padia e paditësit që të vërtetohet se i padituri është përgjegjës për fyerje në emision televiziv Analiza 24 në programin televiziv 24 Vesti dhe për fyerjen e bërë ti paguan kompensim jomaterial për cenim të nderit dhe reputacionit në vlerë prej 150.000,00 denarësh, si dhe me shpenzimet e veta ta publikon përmbajtjen e aktgjykimit në një gazetë në hapësirë jo më të vogël se 1/8 e faqes nga e para deri te faqja e pestë të mjeteve të shtypit.

Kërkesa e paditësit që ta ngarkon të paditurin për ti kompensuar shpenzimet e procedurës në vlerë totale prej 217.000,00 denarë është refuzuar si e paba-







## AKTGJYKIM P5-17/16

- Padiës: XH.M. nga S.
- Të paditur: M.N. me vendbanim të panjohur si person fizik dhe Shoqëri e produksionit V.I- M DOOEL S. si person juridik
- Baza: Kompensim i dëmit për shpifje
- Vlera: 307.500,00 denarë

Pas zbatimit të procedurës për caktimin e përgjegjësive së të paditurit për shpifje, kërkes-padia e paditësit u pranua pjesërisht.

Është caktuar përgjegjësi për të paditurin e parë M.N. për kryerjen e fyerjes si autor i tekstit publikuar më 02.12.2015 në faqen e internetit dhe i njeiti obligohet që në bazë të kësaj ti paguan paditësit në emër të kompensimit të dëmit jomaterial përshkak të cenimit të të dhënave personale të nderit dhe reputacionit vlerën prej 30.000,00 eurosh me kamata të ndëshkuar ligjore vlerësuar nga dita e aktgjykimit deri në ditën e pagesës, si dhe ti paguan shpenzimet e procedurës në vlerë prej 93,682,00 denarë.

Kërkesa e paditësit për kompensim të dëmit ndaj të akuzuarit të parë për dalim nga vlera e paralajmëruar e 153.750,00 denarësh deri te vlera e caktuar prej 30.000,00 denarësh ose vlera prej 123.750,00 denarë me kamata të ndëshkuar ligjore, si dhe kërkesa për shpenzimet e dalluara nga vlera e paralajmëruar e 125.666,00 denarësh deri te vlera e caktuar prej 93.682,00 denarë ose për vlerën prej 31.984,00 denarë, është refuzuar si e pabazë.





## AKTGJYKIM P5- 15/16

- Paditës: T.T. nga P, nëpërmjet të autorizuarit
- I paditur: T.S. nga P, nëpërmjet të autorizuarit
- Baza: Kompensim i dëmit për shpifje
- Vlera: 600.000,00 denarë

Pas zbatimit të procedurës me kërkesë-padi të paditësit person fizik T.T. kundër të paditurit person fizik T.S. nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me kërkesë për caktimin e përgjegjësisë për shpifje e kryer nga e paditura si autore e kolumnës me datë 19.12.2015 e publikuar në faqen e Facebook-ut dhe kërkesën që të obligohet e paditura përshkak të cenimit të të drejtave personale (nderit dhe reputacionit) të paditësit përshkak të shpifjes së bërë me fjalët „vrasës, kriminel, shkatërues, i involvuar në të gjitha bizneset, kërcënues, i involvuar në bizneset e zeza dhe në rrjetin narkotik, baba i një djaloshi të çmendur dhe të pazakontë dhe okupues publik i “gjithçkaje në qytet” ti paguan kompensim në të holla të dëmit jomaterial në vlerë prej 600.000,00 denarësh, si dhe të obligohet e paditura të kërkoj falje publike dhe ta tërheq deklaratën e dhënë në të njëjtin vend dhe me të njëjtën masë dhe ti ndalohej që ta përsëris deklaratën e njëjtë, ndërsa paditësit t’ia kompenzon shpenzimet e procedurës, gjykata e ka refuzuar kërkesë-padinë si të pabazë.



## PËRFUNDIM

- Në tre analizat e mëparshme të përpunuara në bashkëpunim me SHGM, si problem kryesor është paraqitur periudha kohore e zgjatjes së procedurës.

Sipas nenit 22 të Ligjit për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje, „procedura pas një padie për caktimin e përgjegjësisë për fyerje ose shpifje dhe kompensim të dëmit është urgjente”. Gjykata është e obliguar që ta zbaton procedurën pa anulime dhe në afat të arsyeshëm kohor.

Duke pasur parasysh faktin që nga paraqitja e padisë deri te sjellja e vendimit të shkallës së parë procedurat mesatarisht kanë zgjatur nga dy vite e gjysme, përsëri edhe në këtë analizë vërehet qartë problemi me mungesën e efikasitetit të gjykatave në veprim.

Pas skadimit të këtyre periudhave, në procedurat tek të cilat është pranuar kërkes-padia, aktgjykimi nuk i prodhon efektet që janë të parapara të arihen me ligj - mbrojtja e nderit dhe reputacionit dhe zbutjen e pasojave nga shkaktimi i fyerjes dhe shpifjes.

- Nga analiza e vendimeve shihet qartë se gjykata në rastet në të cilat njëra palë është gazetar që punon në mediumet online shpesh herë e refuzon kërkes-padinë përshkak të mungesës së legjitimitetit pasiv të paditurit. Me këtë praktikisht gjykata nuk i pranon portalet online si medime. Në dy nga këto aktgjykime gjykata është thirrur në dispozitat e nenit 6 paragrafi 3 dhe nenit 8 paragrafi 3 të LCPFSH-së, në të cilat është vërtetuar se paraqet mjet për informim:

*“gazetat, revista dhe shtype tjera, programe të radiove dhe televizive, botime elektronike, teletekste dhe forma tjera të përmbajtjes së programit në formë të redaktuar që publikohen, gjegjësisht që emitohen në të përditshme dhe periodike në formë të shkruar, tinguj ose fotografi, në mënyrë të disponueshme për opinionin e gjërë”.*

Kështu, në Aktgjykimin e Gjykatës themelore Shkupi II P5 73/16 (paraprakisht e përfshirë dhe e cituar), gjykata e refuzon kërkes-padinë si të pabazë sepse vlerëson që fyerjet dhe shpifjet nëpërmjet internet portalit privat nuk paraqesin mjet për informim.

Njëkohësisht, në vitin 2018 ka shembuj nga procedura të përfunduar gjyqësore në qytetet tjera të Maqedonisë, si përshebull Ohër dhe Manastir, në të cilat gjykata nuk ka dilemë që mediat online paraqesin medime dhe vepron në bazë të padive.

Kjo tregon për faktin se gjykatat kanë praktikë të ndryshme në raport me trajtimin e mediave online. Një pjesë e gjykatave i pranojnë portalet si medium, ndërsa pjesa tjetër nuk i pranon.

*Neni 3 i Ligjit për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje parasheh që nëse ekziston zbrastirë ligjore apo mospërputhshmëri të dispozitave të Ligjit me Konventën Evropiane të të drejtave të njeriut, të zbatohen dispozitat e Konventës dhe pikëpamjet e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut të përfshira në aktgjykimet e saj, me prioritet mbi ligjin vendas.*

Kjo nënkupton se Gjykata themelore në Shkup nuk ka praktikë të njëjtë me gjykatat tjera të Maqedonisë, por edhe që nuk e ndjek praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strazbur, ku mediat online kanë trajtim të njëjtë sikur mediat tjera.



## Përmbajtje

1. AKTGJYKIM P5-34/16.....	9
2. AKTGJYKIM P5-73/16.....	11
3. AKTGJYKIM P5-1/17 .....	13
4. AKTGJYKIM P5-69/15.....	15
5. VENDIM P5-14/17 dhe PR-15/17 .....	17
6. VENDIM P5-32/17 .....	18
7. VENDIM P5-8/17 .....	19
8. VENDIM P5-22/17 .....	20
9. AKTGJYKIM P5-18/16.....	21
10. AKTGJYKIM P5-72/15 .....	22
11. AKTGJYKIM P5-79/15 .....	24
12. AKTGJYKIM P5-61/16 .....	25
13. AKTGJYKIM P5-17/16 .....	27
14. AKTGJYKIM P5- 15/16.....	29
PËRFUNDIM.....	31







The project is  
implemented by AJM

Ky publikim është punuar në kuadër të projektit “Rrjetëzimi i gazetarëve për lirinë e mediave”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i implementuar nga Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Shoqatës së gazetarëve të Maqedonisë dhe autorëve të saj dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

